



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

Nr 05 Prot.

Vlorë, më 02.01. 2019.

Lënda: Skema e Vlerësimit të kandidatëve për personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2018-2019

Drejtuar: Dekanit të Fakultetit të Shkencave Humane,
Prof. As. Aleks Trushaj

I nderuar Z. Dekan!

Në zbatim të urdhërit nr 115 datë 18.12.2018 për :” Ngritjen e komisionit Ad-Hoc për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për personel akademik me angazhim me kohë të pjesshme në Departamentin e Edukimit për vitin akademik 2018-2019” të Rektorit të UV “Ismail Qemali” Prof.Dr Roland Zisi.

Departamenti i Edukimit përcakton Skemën e Vlerësimit të kandidatëve për personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2018-2019

SKEMA E VLERËSIMIT

1. Në fazën e parë bëhet vlerësimi me pikë duke ju referuar rezultateve të shkollimit për çdo diplomë që zoteron kandidati, eksperiencës në mësimdhënie, aktivitetit shkencor, studimeve të ciklit të tretë, gradës shkencore dhe titujve akademikë si më poshtë:

Rezultatet e shkollimit për çdo diplomë në IAL në Shqipëri:

- Për diplomën “Bachelor” 0,5 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9 -10.
- Për diplomën “4-vjeçare” 0,75 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
- Për diplomën “5-vjeçare” 1 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
- Për diplomën “Master i Shkencave” apo “Master i Nivelit të Dytë” 0.5 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.

2. Rezultatet e shkollimit për çdo diplomë të fituar në universitetet perëndimore:

- Për diplomën “Bachelor” 0,75 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
- Për diplomën “4-vjeçare” 1 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
- Për diplomën “5-vjeçare” 1,5 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
- Për diplomën “Master i Shkencave” 0,75 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.

3. Eksperiencia në mësimdhënie në IAL në Shqipëri:

- Me kohë të plotë 1 pikë për çdo vit pune, por jo me më shumë se 5 pikë në total.
- Me kohë të pjesshme 0,5 pikë për çdo vit pune, por jo me më shumë se 2 pikë në total.

4. Aktiviteti shkencor:

- Botime në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti 5 pikë çdo artikull.
- Botime në revista shkencore ndërkombëtare me bord editorial 2 pikë çdo artikull.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

5. Grada Shkencore dhe tituj akademikë:
- Doktor i Shkencave 50 pikë.
 - PhD në universitetet perëndimore apo Profesor i Asociuar 70 pikë.
 - Profesor i Asociuar 100 pikë.
 - Profesor Doktor 150 pikë
6. Komisioni ad-hoc është përgjegjës për respektimin e kriterëve dhe për procedurën e konkurimit. Komisioni në çdo rast ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë për vërtetësinë e dosjes dhe të deklarimeve.
7. Në fazën e dytë, bëhet vlerësimi me pikë duke iu referuar intervistës me gojë e cila vlerësohet në intervalin nga 1-10 pikë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

Përgjegjësi i Departamentit
Dr Aranit Gjipali

Ky dokument përpilohet në 3 (tre) kopje.